



D-P

Nr Prot
Rr Prot
Prot No 03-348/11

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË /OPSTINSKI SUD ZA
PREKRSAJE U PRISTINI/MUNICIPAL OFFENCES COURT IN PRISTINA

Nr.regj. 16964/2010

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË, duke vendosur në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurës Lindita Rugova nga Prishtina, për kundërvajtjen nga neni 16 paragrafi 1.1 të Ligjit mbi Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarëve të lartë Publik, e ne bazë të nenit 73, 74, 195, dhe konformë nenit 198 al. 1 pika 2 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, merr këtë:

AKTVENDIM

PEZULLOHET: Procedura kundërvajtëse kundër të pandehurës Lindita Rugova, e lindur me 1975 në Vranjë tani jeton në Prishtinë rr. Bregu i diellit Zona Perëndimit 1/4 për kundërvajtjen nga neni 16 paragrafi 1.1 të Ligjit mbi Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarëve të lartë Publik, konform nenit 198 al. 1 pika 2 të Ligjit mbi Kundërvajtjet për shkak të ekzistimit të rrethanave që e përjashtojnë përgjegjësinë kundërvajtëse. Shpenzime të procedurës nuk ka patur. Nga një kopje të këtij aktvendimi duhet dorëzuar palës dhe ushtruesit të kërkesës.

Arsyetim

AGJENCIA kundër Korrupsionit në Prishtinë, parashtroj gjykatës kërkesën nr. 01/2307/10 më dt. 15.06.2010 për fillimin e procedurës kundërvajtëse kundër të pandehurës Lindita Rugova dhe për kundërvajtjen nga neni 16 paragrafi 1.1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarëve të lartë Publik për shkak se në cilësinë e zyrtares së lartë publike nuk e ka deklaruar pasurinë për vitin 2010.

Në seancën gjyqësore të caktuar për datë 10.02.2011 e pandehura në mbrojtjen e vet deklaroi se nuk ka qenë e njohtuar rreth deklarimit të pasurisë gjerë më datë 31.03.2010 dhe për këtë Gjykatës i ofroi prova. Në vazhdim kjo e pandehur thekson gjithashtu se nuk e ka ditur se gjendet në listën e zyrtarëve të lartë publik, të cilët janë të obliguar ta deklarojnë pasurinë. Si prodekane për mësim në Fakultetin e Filologjisë ka filluar punën më datë 01.11.2009 dhe ato ditë ka qenë duke u zhvilluar procedura e Akreditimit të Fakultetit të Filologjisë me 18 programe mësimore kështu që ka qenë e përkushtuar rreth këtyre punëve, ndërsa në Agjencinë kundër Korrupsionit ka shkuar më datë 04.06.2010 për ta dorëzuar formularin e plotësuar mbi gjendjen e pasurisë, mirëpo kjo agjenci nuk e ka pranuar me arsyetim se ka kaluar afati ligjor për dorëzim. Kërkon nga Gjykata që të ketë për bazë këto rrethana e sidomos faktin që gjerë më tani asnjëherë nuk ka ra ndesh me ligjin si dhe mosefikasitetin e komunikimit midis Agjencisë Anti korrupsion dhe Fakultetit të Filologjisë.

Nga te dhenat e parashtruara ne kërkesë, deklarata e të pandehurës, si dhe nga vlerësimi i të gjitha provave tjera të deponuara në lëndë, Gjykata konstatoi se ekzistojnë rrethana që e përjashtojnë përgjegjësinë kundërvajtëse, andaj në vështrim të nenit 198 al. 1 pika 2 të LMK ndaj të pandehurës së përmendur më lartë u **PEZULLUA** procedura dhe u vendos si ne dispozitiv të këtij aktvendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë 8 ditë pas marrjes së të njëjtit nëpërmjet kësaj Gjykate pa taksa..

U VENDOS NË GJYKATËN KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË

Me dt. 10.02.2011

KRYETARI I GJYKATËS

Mustafë Selimi

